



Federata e Pingpongut e Kosovës
Table Tennis Federation of Kosova

Shtëpia e Sporteve, rr. Agim Ramadani Nr. 43, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383.44.170 586 e-mail: info@fppk.com www.fppk.com

REGULLORE PËR SISTEMIN E
GARAVE

PRISHTINË 2022

Në përputhje me nenin 15 paragrafi 2.1 të Statutit të Federatës së Pingpongut të Kosovës të datës 10 nëntor 2020, Federata e Pingpongut e Kosovës, në mbledhjen e datës: xx/xx/2022 miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR SISTEMIN E GARAVE TË FEDERATËS SË PINGPONGUT TË KOSOVËS**

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim caktimin e sistemit të garave të pingpongut të Federatës së Pingpongut (në tekstin e mëtejshëm FPPK) për të gjitha kategoritë e pingpongistëve, mënyrën e zhvillimit të garave në kampionatin ekipor dhe kampionatet/turnetë individuale të Kosovës.

**Neni 2
Llojet dhe tipi i garave**

1. Garat sipas kësaj Rregullore janë zyrtare dhe jozyrtare.
2. Të gjitha garat zyrtare të parapara nga kjo Rregullore e përbëjnë bazën për kategorizimin e klubeve të pingpongut dhe të anëtarëve të tyre.
3. Gara jo zyrtare konsiderohen garat që nuk janë pjesë e kësaj Rregulloreje sikurse takimet miqësore dhe ato stërvitore, si dhe paraqitjet në garat me karakter argëtues dhe promovues.
4. Garat mund të jenë të tipit të hapur apo të mbyllur.
5. Në garat e tipit të hapur të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjitha ekipet e regjistruara në FPPK dhe individët në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje.
6. Në garat e tipit të mbyllur të drejtë pjesëmarrjeje kanë ekipet dhe individët të cilët e kanë fituar këtë të drejtë duke i plotësuar kushtet sipas kësaj Rregulloreje.

**Neni 3
Të drejtat dhe përgjegjësitë e klubeve dhe pingpongistëve**

Është e drejtë dhe detyrë e klubeve dhe pingpongistëve që rregullisht të marrin pjesë në gara të organizuara nga FPPK-ja.

**Neni 4
Kalendari i garave**

1. Para fillimit të çdo viti garues përpilohet kalendari i garave. Me kalendarin e garave vërtetohet:

1.1. vendi dhe koha e mbajtjes së garave që parashihen nga kjo Rregullore;

1.2. paraqitjet e përzgjedhjes, si dhe mbajtja e turneve përkujtimor dhe promovues të cilët Bordi ekzekutiv i vlerëson si të rëndësishëm për zhvillimin dhe popullarizimin e pingpongut.

2. Propozimi i kalendarit të garave duhet të jetë gati çdo vit jo më vonë se 1 shkurti i vitit aktual.

3. Hartimi i kalendarit bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm në konsultim me Drejtorin e Përfaqësueses dhe Komisionin e Garave. I njëjti i procedohet për shqyrtim dhe miratim në parim nga Bordi Ekzekutiv dhe më pas u dërgohet klubeve për propozime shtesë. Pas përfundimit të procesit të konsultimeve, Bordi Ekzekutiv e procedon Kalendarin e Garave për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Ndryshimet dhe plotësimet e Kalendarit bëhen nga Bordi Ekzekutiv përgjatë vitit.

4. Kalendari i miratuar, jo më vonë se tre ditë pas miratimit publikohet në faqen zyrtare të FPPK-së dhe i njëjti i shpërndahet klubeve dhe anëtarëve të FPPK-së.

II LLOJET E GARAVE SIPAS KATEGORISE, NIVELIT DHE GJINISE

Neni 5

Llojet

1. Garat e pingpongut në Kosovë ndahen sipas kategorisë, nivelit dhe gjinisë.

Neni 6

Garat sipas kategorisë

1. Garat zyrtare sipas kategorisë mbështeten në moshën e garuesve dhe mbahen sipas kategorive:

- 1.1. Seniorë dhe Seniore,
- 1.2. U21 Seniorë/Seniore të rinj
- 1.3. U19 Juniorë/Juniore,
- 1.4. U17 Juniorë/Juniore të rinj
- 1.5. U15 Kadetë dhe Kadete.
- 1.6. U13 Kadetë/kadete të rinj
- 1.7. U11 Minikadetë dhe Minkadete.

2. Garat jozyrtare mbahen në kategorinë e:

- 2.1. U9 Shpresat
- 2.2. Veteranëve.

3. Në kategoritë seniorëve dhe senioreve, në garat ekipore, mund të paraqiten të gjithë anëtarët e regjistruar në FPPK pa marrë para sysh moshën, kurse në garat individuale vetëm lojtarët më të vjetër se 15 vjeç, ndërsa për lojtarët më të rinj, komisioni i garave ka të drejtë që të lejojë pjesëmarrjen, sipas kërkesës së klubit, nëse lojtari është i pari në ranglistën e U13

4. Në kategorinë U21, në garat ekipore mund të paraqiten të gjithë anëtarët e regjistruar në FPPK, të cilët deri në fillim të vitit kalendarik (01 janar) nuk i kanë mbushur 21 vjet. Ndërsa në garat individuale vetëm lojtarët më të vjetër se 13 vjeç, ndërsa për lojtarët më të rinj, komisioni i garave ka të drejtë që të lejojë pjesëmarrjen, sipas kërkesës së klubit, nëse lojtari është i pari në ranglistën e U11.

5. Në kategoritë U19 në garat ekipore mund të paraqiten të gjithë anëtarët e regjistruar në FPPK, të cilët deri në fillim të vitit kalendarik (01 janar) nuk i kanë mbushur 19 vjet. Ndërsa në garat individuale vetëm lojtarët më të vjetër se 13 vjeç, ndërsa për lojtarët më të rinj, komisioni i garave ka të drejtë që të lejojë pjesëmarrjen, sipas kërkesës së klubit, nëse lojtari është i pari në ranglistën e U11.

6. Në kategoritë U17 në garat ekipore mund të paraqiten të gjithë anëtarët e regjistruar në FPPK, të cilët deri në fillim të vitit kalendarik (01 janar) nuk i kanë mbushur 17 vjet. Ndërsa në garat individuale vetëm lojtarët më të vjetër se 11 vjeç, ndërsa për lojtarët më të rinj, komisioni i garave ka të drejtë që të lejojë pjesëmarrjen, sipas kërkesës së klubit, nëse lojtari është i pari në ranglistën e U9

7. Kategorinë U15 e përbëjnë lojtarët të cilët deri në fillim të vitit kalendarik (01 janar) nuk i kanë mbushur 15 vjet.

8. Kategorinë U13 e përbëjnë lojtarët të cilët deri në fillim të vitit kalendarik (01 janar) nuk i kanë mbushur 13 vjet.

9. Kategorinë U11 e përbëjnë garuesit, të cilët deri në fillim të vitit kalendarik (01 janar) nuk i kanë mbushur 11 vjet.

10. Kategoritë U9 e përbëjnë garuesit, të cilët deri në fillim të vitit kalendarik (01 janar) nuk i kanë mbushur 9 vjet.

11. Veteranë konsiderohen garuesit të cilët deri në fund të dhjetorit të vitit rrjedhës do t'i mbushin 40 vjet e më shumë, të cilët ndahen grupmosha mbi 40, mbi 50, mbi 60, mbi 65, mbi 70, mbi 75. Më kusht që në grupmoshë të ketë së paku 5 garues, në të kundërtën ata garojnë në grupmoshë më të re.

Neni 7 **Garat sipas nivelit**

1. Garat zyrtare sipas nivelit ndahen në:

- 1.1. I Garat komunale;
- 1.2. II Garat kampionale;
- 1.3. III Garat ndërkombëtare.

2. Në garat e nivelit I kanë karakter të hapur masivizimi dhe në to mund të marrin pjesë, përveç ekipeve dhe lojtarëve të klubeve edhe lojtarët e organizatave punuese, shkollave, si dhe secili lojtar i cili paraqitet për të marrë pjesë në atë garë.

3. Garat individuale dhe ekipore të nivelit II sipas rregullit janë të tipit të mbyllur, kurse të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë anëtarët e FPPK-së në pajtim me nenin 11 të kësaj Rregulloreje.

4. Në qoftë se është në interes të pingpongut, në bazë të marrëveshjes kombëtare të një apo më shumë vendeve mund të formohen forma të përkohshme ose të përhershme të garave. Me propozicionet për forma të garave ndërkombëtare caktohet arritja e të drejtës për paraqitje, mënyra e të luajturit, udhëheqja e garës, aspektet materiale dhe çdo gjë tjetër me rëndësi për zhvillimin e garës.

Neni 8 Garat sipas gjinisë

1. Për të gjitha kategoritë dhe për të gjitha nivelet zhvillohen garat posaçërisht për meshkuj dhe posaçërisht për femra.
2. Në të gjitha kategoritë dhe në të gjitha nivelet e garave, femrat nuk mund të garojnë në konkurrencën e meshkujve dhe anasjelltas.
3. Përfundimisht, në garat e nivelit I, femrat mund të bëjnë gara edhe në konkurrencën e meshkujve.

III. E DREJTA PËR PJESËMARRJE NË GARË

Neni 9 Pjesëmarrja

1. Në garat ekipore, nga kjo Rregullore, mund të marrin pjesë të gjitha klubet e regjistruara në FPPK.
2. Në garat individuale, të cilat pikëzohen për ranglistën e FPPK-së, mund të paraqiten:
 - 2.1. lojtarët dhe lojtaret që janë shtetas të Kosovës të regjistruar në FPPK;
 - 2.2. lojtarët dhe lojtaret shtetas të Kosovës, të cilët me lejen e FPPK-së janë të regjistruar në klubet e huaja, të cilët sipas rregullave të ITTF-it mund të paraqiten për përzgjedhjen e Kosovës.
3. Përfundimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, me ftesën e përzgjedhësit të përfaqësueses, në garat individuale mund të paraqiten lojtarët dhe lojtaret shtetas të Kosovës të

regjistruar në FPPK, të cilët sipas rregullave të ITTF-it nuk kanë të drejtë të paraqiten për përzgjedhjen e Kosovës.

4. Kur trajneri i përzgjedhjes i fton në garë lojtarët dhe lojtaret, të cilët sipas rregullave të ITTF-it, nuk kanë të drejtë të paraqiten për përzgjedhjen e Kosovës, numri i lojtarëve të tillë të ftuar nuk mund të jetë më i madh se numri, i cili me këtë Rregullore i është lënë në kompetencë trajnerit të përzgjedhjes për garën përkatëse.

Neni 10 **Rregullat për garuesit**

1. Një garues mund të jetë i regjistruar vetëm për një klub. Përyjashtimisht, garuesit me perspektivë, mund të kenë regjistrim të dyfishtë në mënyrë që me regjistrim të dyfishtë lejohet paraqitja vetëm në konkurrencën e të rriturve për klubin e ri për të cilin është regjistruar. Në një ndeshje për një klub mund të paraqitet vetëm një lojtar me regjistrim të dyfishtë.

2. Garuesit e kategorive të reja mund të bëjnë gara ekipore në kategoritë më të vjetra, por nuk mundën që brenda një dite të paraqiten në dy grup-mosha.

3. Garuesit e kategorive të reja në garat individuale, kur ofrohet si mundësi, brenda një dite kanë të drejtë të paraqitet më së shumti në dy grup-mosha.

IV. GARAT

Neni 11 **Zbatimi i rregullave**

1. FPPK zbaton rregullat e pingpongut të vërtetuara sipas ITTF-it (Handbook, kreu 2).

2. Organizimi i të gjitha garave në FPPK bazohet në këtë Rregullore. Rregulloren për organizimin e garave të FPPK-së.

3. Organizimi i garave ndërkombëtare në Kosovë bazohet në rregullat e ITTF-it dhe ETTU-së për gara ndërkombëtare.

Neni 12 **Zhvillimi i ndeshjeve ekipore**

1. Të gjitha ndeshjet ekipore do të zhvillohen sipas njërës prej sistemeve për garat ekipore që gjinden në Handook të ITTF për garat ekipore me ndryshime të aprovuara nga bordi apo kuvendi.

2. Sistemi numër një (Sistemi i ri i Kupës Swaythling / New Swaythling Cup) zhvillohet si në vijim:

zhvillohen 5 ndeshje individuale, ashtu që lojtarët takohen sipas kësaj renditjeje:

A - X
B - Y
C - Z
B - X
A - Y

Luhet derisa njëra skuadër të shënojë tri (3) fitore.

Kur gjatë garave ekipet takohen dy herë, mikpritësi gjithmonë e ka përbërjen ABC, e nëse takohen vetëm një herë përbërja caktohet me short.

3. Sistemi numër dy (Sistemi C i Kampionatit Evropian / C EUROPEAN CHAMPIONSHIPS) zhvillohet si në vijim:

Luhet derisa njëra skuadër të shënojë tri (3) fitore. Ekipi përbehet prej 3 apo 4 Lojtaresh. Para ndeshjes kapitenët përcaktojnë lojtarët që do të luajnë si vendas A, B dhe C, apo si mysafir X, Y dhe Z si dhe lojtarin rezerve. Para fillimit të lojës së tretë kapiteni i ekipit do të vendose nëse do të përdorë lojtarin rezerve dhe do të përcaktoj se a do ta vendos si lojtarin A apo B nëse është vendas, ose si lojtarin X apo Y nëse është mysafir.

4. Sistemi numër tre zhvillohet si në vijim:

Sistemi me 4 të fituara, zhvillohet ashtu që lojtarët takohen sipas kësaj renditjeje:

A - Y
B - X
C - Z
Çiftet
A - X
C - Y
B - Z

Luhet derisa njëra skuadër të shënojë katër (4) fitore.

Kur gjatë garave ekipet takohen dy herë, mikpritësi gjithmonë e ka përbërjen ABC, e nëse takohen vetëm një herë përbërja caktohet me short.

Ekipi përbehet prej 3, 4 apo 5 lojtaresh. Para ndeshjes kapitenët përcaktojnë lojtarët që do të luajnë si vendas A, B dhe C, apo si mysafir X, Y dhe Z si dhe lojtarët rezerve. Para fillimit të lojës së çifteve, kapiteni i ekipit do të vendose nëse do të përdorë lojtarët dhe në cilat pozita.

5. Sistemi numër katër (Sistemi Olimpik / Olympic system) zhvillohet si në vijim:

Sistemi me tre të fituara, zhvillohet ashtu që lojtarët takohen sipas kësaj renditjeje:

A vs X
B vs Y
A ose B dhe C vs X ose Y dhe Z
A ose B vs Z
C vs Y ose X

Luhet derisa njëra skuadër të shënojë tri (3) fitore, 4 lojëra individuale dhe 1 loje me çifte. Ekipi përbehet prej 3 lojtareve. Para ndeshjes kapitenët përcaktojnë lojtarët që do të luajnë si vendas A, B dhe C (çiftin), apo si mysafir X, Y dhe Z (çiftin).

Neni 13

Setat dhe pikët

1. Të gjithë setat luhen në 11 pikë të fituara. Në rast kur të dy lojtarët i kanë nga 10 pikë, do të fitojë ai lojtar që i pari i fiton dy pikë më shumë (dy pikë diferencë).
2. Të gjitha takimet në ndeshjet ekipore (individuale dhe të çifteve) luhen në tre seta të fituar.

Neni 14

Rregulli i setave

1. Të gjitha ndeshjet në lojën e çifteve zhvillohen në 3 seta të fituar.
2. Të gjitha ndeshjet individuale luhen në 3 seta të fituar.
3. Përjashtimisht, të gjitha ndeshjet në turnetë e hapur dhe në turnetë e hapur kualifikues të grup-moshave të reja (minikadet, kadetë dhe juniorë) luhen në tre seta të fituar.

Neni 15

Kur garës individuale me sistem eliminues i paraprijnë kualifikimet nëpër grupe atëherë, nëse janë 8 ose më pak grupe kualifikohen dy të parët e grupit, kurse nëse janë më tepër se 9 kualifikohet vetëm fituesi i grupit.

Neni 16

Kur turneut me sistem eliminues i paraprijnë kualifikimet nëpër grupe, çdo grup përbëhet nga 3-5 lojtarë ose ekipe, të cilët takohen ndërmjet vete, secili me secilin. Plasmani në grup caktohet sipas mënyrës së vërtetuar në nenin 21 të kësaj Rregulloreje.

Neni 17

1. Në garat ekipore dhe individuale ku të gjitha ekipet apo lojtarët takohen ndërmjet vete, renditja përcaktohet në bazë të pikëve të fituara. Dy pikë fitohen për fitore, një pikë për humbje, kurse asnjë pikë për ndeshjen e pa luajtur ose të papërfunduar.
2. Nëse dy ose më shumë ekipe përkatësisht individë fitojnë numër të njëjtë pikësh, plasmani i tyre caktohet vetëm nga rezultati i takimeve të tyre të ndërsjella, duke marrë parasysh sipas kësaj radhitjeje: numrin e pikëve të fituara, numrin e fitoreve dhe humbjeve të dueleve individuale, setave të fituar dhe të humbur dhe numrin e pikëve të

fituara dhe të humbura në seta. Nëse pas veprimeve të mësipërme është përcaktuar vendi i një apo më shumë anëtarëve të grupit, kurse të tjerët ende janë të barabartë, e tërë procedura përsëritet duke i marrë parasysh vetëm rezultatet e anëtarëve të grupit, të cilët kanë mbetur të barabartë.

Neni 18

1. Në pajtim me standardet e vërtetuara mjekësore, lojtari mundet brenda një dite të luajë:

1.1. Takime ekipore deri në fitoren e tretë, deri në fitoren e katërt të një ekipi

Ora	9-14 (5 orë)	4 ndeshje	6 ndeshje
	16-21 (5 orë)	4 ndeshje	6 ndeshje
	9-21 (12 orë)	6 ndeshje	8 ndeshje

1.2. Ndeshje individuale në 4 seta të fituar në 3 seta të fituar

	9-14 (5 orë)	4 ndeshje	6 ndeshje
	16-21 (5 orë)	4 ndeshje	6 ndeshje
	9-21 (12 orë)	6 ndeshje	8 ndeshje

2. Për turnetë njëditorë (në kohëzgjatje më shumë se 7 orë), lojtarëve duhet t'u sigurohet pushim prej së paku 2 orëve.

Neni 19

Në garat e nivelit III, një klub mund të bëjë gara vetëm me një ekip të meshkujve dhe një të femrave.

V. SHORTI

Neni 20

Propozimi i shortit

Shortin për garat ekipore dhe individuale e propozon Bordi i të FPPK-së pas propozimit të Komisionit të garave dhe i njëjti aprovet në Kuvendin e FPPK.

Neni 21

Përcaktimi i bartësve

1. Për çdo garë përveç Ligës caktohen bartësit.

2. Numri i bartësve caktohet sipas llojit të garës (sistemi eliminues ose i turneut) dhe sipas numrit të garuesve.

3. Bartësit në garat individuale caktohen sipas ranglistës evropiane përkatësisht asaj të FPPK-së.

4. Bartësit në garat ekipore caktohen me llogaritjen e pozitës (mbledhjen e pikëve të rejtingut) 3 lojtarët më të mirë në ranglistën aktuale të FPPK-së. Pikët ranguese të një individi caktohen në bazë të kësaj tabele:

Vendi: 1 – 2.....	25 pikë
3 – 4	20 pikë
5 – 8	15 pikë
9 – 16.....	10 pikë
17 – 32.....	5 pikë
33	3 pikë

5. Në rast se dy ose më shumë ekipe kanë renditje të tërësishme të njëjtë, më i mirë është ekipi, i cili e ka lojtarin e parë më mirë të plasuar në ranglistën aktuale.

6. Gjatë caktimit të bartësve në garat individuale, aty ku është e mundur, përparësi ka ranglista evropiane ndaj ranglistës aktuale të FPPK-së. Seniorët dhe senioret e plasuar nga vendi i parë (1), deri në të pesëdhjetin (50) në ranglistën evropiane, kurse në kategoritë më të reja të lojtarëve juniorët e plasuar në ranglistë nga vendi i parë (1) deri në të njëzetin (20), kadetët e plasuar në ranglistën evropiane prej vendit të parë (1) deri në të dhjetin (10) do të caktohen për bartës, sipas rendit me të cilin janë të plasuar në ranglistën evropiane. Drejtori i përfaqësueses, lojtarin që është i regjistruar për klubin e huaj (dhe që ai nuk është në asnjë ranglistë) mund ta caktojë, për bartës, në bazë të cilësive të tij reale si lojtar. Bartësit në lojën e çifteve, (te femrat dhe të meshkujt) caktohen sipas tabelës nga neni 21. Bartësit për çifte të përziera caktohen sipas tabelës nga neni 21. me atë që pikët e lojtares shumëzohen me faktorin 0.7.

Neni 22

1. Në garat me sistem eliminues:

1.1. Bartësi i parë vendoset në fillim të skeletit, kurse i dyti në fund të skeletit;

1.2. Bartësi i 3 dhe i 4 me short caktohen në fund të gjysmës së parë dhe në fillim të gjysmës së dytë të skeletit;

1.3. Bartësi 5-8 caktohen me short në fund të çerekut të mëparshëm dhe në fillim të çerekut të ardhshëm të skeletit;

1.4. Bartësi 9-16 me short caktohen në fund të të tetës paraprake dhe në fillim të të tetës së ardhshme të skeletit.

Neni 23

1. Kur gara ose para gara zhvillohet në grupe, atëherë në çdo grup caktohet bartësi, e nëse janë 8 ose më pak grupe atëherë edhe nënbartësit.

2. Fituesit e grupeve konsiderohen, si bartës dhe me short caktohen në ato vende në skelet, të cilat i përkasin asaj kategorie të bartësve.

3. Nëse janë 8 ose më pak grupe atëherë i dyti në grup, me short, caktohet në vendet e lira në skelet, me kusht që në xhiron e parë nuk mund të takohen lojtarët që kanë luajtur në grup.

Neni 24

Tërheqja për garat me sistem të turneut bëhet me tërheqjen e thjeshtë të pozitës në tabelën e turneut, duke pasur parasysh që lojtarët e klubit të njëjtë të takohen që në fillim të garës.

Neni 25

Nëse gara, që nga fillimi, zhvillohet me sistem eliminues, atëherë lojtarët e klubit të njëjtë nuk mund të takohen në xhiron e parë. Nëse për hyrje në skelet ka para gara, atëherë në grupin e njëjtë nuk mund të takohen lojtarët e klubit të njëjtë.

Neni 26

Tërheqja e shortit

1. Shorti i tërhequr njëherë sipas rregullit nuk mund të ndërrohet.

2. Përbashimisht nga paragrafi 1 i këtij neni ndryshim në short mund të bëhet në rastet:

2.1. Kur vërtetohet se është bërë gabim në tërheqjen e shortit;

2.2. Mungesa e numrit më të madh të bartësve që seriozisht e çrregullon baraspeshën në skelet, për ç 'shkak komisioni i garave vendos:

2.2.1. Për tërheqje të serishme të shortit.

2.2.2. Që të bëhet tërheqje e re vetëm për bartësit,

2.2.3. Që të pranohet gjendja ekzistuese.

Neni 27

Nëse në gara prishet baraspesha numerike e lojtarëve në grupe, komisioni i garave, me short, e baraspeshon grupin pa prekur në bartësit e grupit.

VI. GARAT EKIPORE PËR SENIORËT DHE SENIORET

Neni 28

Liga e Kosovës

1. Garat ekipore në Ligën e Kosovës organizohen në këtë mënyrë:
 - 1.1. Nëse FPPK-ja ka deri në 12 klube atëherë kemi një(1) Ligë;
 - 1.2. Nëse FPPK-ja ka më tepër se 12 klube atëherë formohen 2 liga me nga 6 ekipe;
 - 1.3. Nëse FPPK-ja ka 14 klube e më tepër atëherë Ligën e parë do ta përbëjnë 8 klube kurse në Ligën e dytë do të marrin pjesë numri tjetër i mbetur i klubeve.
2. Gara zhvillohet në dy stinorë:
 - 2.1. Pranveror;
 - 2.2. vjeshtor.
3. Kampione bëhet skuadra, që në fund të kampionatit renditet e para, kurse nga liga largohen dy ekipet e fundit. Me vendim të bordit mund të shtohet edhe playoffi për të caktuar kampioni ndër 4 të parët dhe payouti për 4 të fundit.

Neni 29

Liga e parë plotësohet ashtu që dy ekipet e para nga liga e dytë drejtpërdrejtë renditen në ligën e parë. Me vendim të bordit mund të shtohet ndeshja e barazhit ndërmjet të parafundit nga liga e parë dhe të dytit nga liga e dytë, për të caktuar klubin që do të vazhdon garat në ligën e parë.

Neni 30

1. Me garat në Ligat e Kosovës udhëheq komisioni i garave, të cilin e emëron Bordi i FPPK-së.
2. Të gjitha harxhimet e organizimit dhe zhvillimit të garave i bartin klubet e ligës, nëse nuk merret ndonjë vendim tjetër nga bordi.

VII. GARAT PËR KUPËN E KOSOVËS

Neni 31

1. Në garat për Kupën e Kosovës mund të bëjnë gara ekipet nga regjioni i Kosovës.
2. Me kushte të njëjta mund të marrin pjesë përbërjet e organizatave punuese, shkollave, dhe përfaqësuesit e shoqatave të tyre (një lojtar mund të jetë i paraqitur dhe të luajë vetëm për një klub).

3. Kupa e Kosovës luhet me sistem eliminues deri në fund.
4. Garat në një kategori organizohen nëse paraqiten më shumë se 3 klube.

Neni 32

1. Në përfundimtare të Kupës inkuadrohen edhe ekipet e Ligës së parë.
2. Bartësi i parë është ekipi fitues nga viti paraprak. Bartësit II, III dhe IV, caktohen sipas nenit 24 të kësaj Rregulloreje. Të gjitha vendet tjera në skelet plotësohen me short.

Neni 33

1. Përfundimi i garës për Kupë zhvillohet në formë të një turneu.
2. Klubi i cili i mund të gjithë kundërshtarët e saj e arrin titullin e fituesit të Kupës së Kosovës.

VII. GARAT INDIVIDUALE

Neni 34 Kampionati i Kosovës

Kampionati i Kosovës është i tipit të hapur. Në kampionat, mund të marrin pjesë të gjithë lojtarët e Ligës së parë dhe të dytë si dhe garat zhvillohen me sistem eliminimi.

Neni 35

1. Në kampionatin e Kosovës garat zhvillohen në këto disiplina:
 - 1.1. Meshkujt –individualisht;
 - 1.2. Femrat – individualisht;
 - 1.3. Çiftet e meshkujve;
 - 1.4. Çiftet e femrave;
 - 1.5. Çiftet e përziera (luhen në konkurrencën e seniorëve dhe atë të juniorëve).

Neni 36

Top turnetë e Kosovës

1. Top turnetë bazohen në grup-moshat e seniorëve dhe të juniorëve, me qëllim të demonstrimit të cilësisë e me këtë edhe promovimit medial për avancimin e pingpongut dhe për çështje të marketingut.
2. Top turnetë mund të jenë me nga tetë apo me nga 12 pjesëmarrës. Në turne të gjithë lojtarët takohen ndërmjet vete.
3. Turnetë zhvillohen gjatë dy ditëve (me orar 2-3-2 me 8 lojtarë përkatësisht 3-4-4 me 12 lojtarë.
4. Në turnetë me 8 lojtarë marrin pjesë 6 lojtarët më të mirë sipas ranglistës për vitin rrjedhës dhe dy lojtarë sipas vendimit të trajnerit të përzgjedhjes.
5. Në turnetë me 12 lojtarë marrin pjesë 9 lojtarë sipas ranglistës rrjedhëse të FPPK-së dhe tre lojtarë sipas vendimit të trajnerit të përzgjedhjes.
6. Autorizimet e Drejtorit të përfaqësueses për t'i ftuar lojtarët në Top turnetë e Kosovës kanë të bëjnë vetëm me shtetasit e Kosovës, të cilët sipas propozicioneve të ITTF-it nuk mund të luajnë për Kosovën, lojtarët apo lojtaret e Kosovës, të cilët me lejen e FPPK-së janë të regjistruar për klubet e huaja, kurse për vitin rrjedhës janë emëruar, si kandidatë për përzgjedhjen e Kosovës dhe lojtarët apo lojtaret e regjistruar për klubet e Kosovës, të cilët mund të paraqiten për përzgjedhjen e Kosovës, kurse për shkaqe të arsyeshme nuk janë paraqitur në turne.
7. Nëse Drejtori i përfaqësueses nuk e shfrytëzon të drejtën e tij apo e shfrytëzon pjesërisht, numri i pjesëmarrësve do të plotësohet me lojtarët apo lojtaret sipas kriterëve të vërtetuara për ftesë në Top turnetë e Kosovës.

Neni 37

Turnetë e ftuar

1. Turnetë e ftuar bazohen në ftesë, kurse kanë për qëllim vërtetimin e formës dhe cilësisë së lojtarëve, para së gjithash kandidatëve për përzgjedhje, si dhe dhënia e mundësisë së fitimit të përvojës dhe përsosurisë sportive, duke luajtur më shumë lojë me kundërshtarë të barabartë.
2. Turneu i ftuar i ka 12 pjesëmarrës.
3. Loja zhvillohet ashtu që lojtarët ndahen në dy grupe me nga 6 lojtarë ku takohen secili me secilin.
4. Në përfundimtarën e turneut formohen tri grupe me lojtarë me plasman të njëjtë (1dhe 2, 3dhe 4, 5dhe 6) në të cilët luhet për renditjen përfundimtare prej vendit të 1 deri të 4,

prej të 5 deri të 8 dhe prej 9 deri të 12, me atë që rezultatet e ndërsjella nga lojtarët në grupe llogariten në përfundimtare të turneut.

5. Turnetë zhvillohen brenda një dite.

6. Përbërja e turneut të parë të ftuar për të gjitha kategoritë e garuesve është:

6.1. 6 lojtarët më të mirë të plasuar në bazë të ranglistës përfundimtare të FPPK-së nga stinori i kaluar (alternativë: ranglista zero për stinorin rrjedhës);

6.2. 3 lojtarët më të mirë nga turneu i hapur klasifikues me të cilin lidhet;

6.3. 3 lojtarë sipas ftesës së përzgjedhësit.

Neni 38

Turnetë e hapur kualifikues

1. Turnetë e hapur kualifikues organizohen për të gjitha kategoritë e garuesve dhe përbëjnë një tërësi me turnetë e ftuar me të cilët janë të lidhur.

2. Turnetë e hapur kualifikues luhen njësoj si ata të hapur por:

2.1. Në turneun e parë të hapur kualifikues nuk mund të marrin pjesë lojtarët të cilët të drejtën për të luajtur në turneun e ftuar e kanë fituar në bazë të ranglistës përfundimtare për vitin paraprak;

2.2. Në turneun e dytë apo në turnetë tjerë eventuale të hapur klasifikues nuk mund të marrin pjesë lojtarët, të cilët të drejtën për të luajtur në turneun e ftuar e kanë fituar në bazë të renditjes në turneun e parë apo të dytë;

2.3. Në bazë të plasmanit të arritur në turneun e hapur kualifikues, 3 lojtarët e plasuar më së miri, përkatësisht lojtarët, e fitojnë të drejtën për të luajtur në turneun e ftuar me të cilin është i lidhur turneu i hapur kualifikues.

3. Suksesi i arritur në turneun e hapur kualifikues pikëzohet për renditje në ranglistën e FPPK-së.

4. Lojtarëve të cilët janë kualifikuar për turneun e ftuar do t'u shënohen pikët ose nga turneu i ftuar ose nga turneu i hapur kualifikues, cilido që të jetë më i përshtatshëm për ta.

Neni 39

Turnetë e hapur

1. Me qëllim që t'u ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së vazhduar në gara mund të organizohen turne të hapur për të gjitha kategoritë e garuesve.

2. Në turnetë e hapur në pajtim me rregullat dhe propozicionet e kësaj Rregulloreje mund të marrin pjesë të gjithë lojtarët e paraqitur.

Neni 40 **Ranglistat**

1. Suksesi i secilit lojtar brenda FPPK-së vërtetohet me pozitën e tij në ranglistë.
2. Ranglistat vërtetohen për stinorin garues, kurse gjatë stinorit bëhen ranglistat aktuale.
3. Mënyra e vlerësimit të rezultateve të arritura zbatohet në përputhje me Rregulloren për hartimin e ranglistës së Federatës së Pingpongut të Kosovës.

IX. PËRZGJEDHJA (PËRFAQËSUESJA)

Neni 41

1. Të përzgjedhurit e pingpongut të Kosovës përfaqësojnë, si individë apo si ekip të Kosovës, FPPK-në, sportin në tërësi dhe Kosovën në garat ndërkombëtare.
2. Për ekipin e përzgjedhjes mund të paraqiten lojtarët, shtetas të Kosovës të regjistruar në klubet e Kosovës apo jashtë kufijve të saj.
3. Caktimi i të përzgjedhurve për tu paraqitur në përzgjedhjen e Kosovës ose në garat individuale ndërkombëtare bëhet në përputhje me Statutin e FPPK-së, Rregullores së punës së Ekipit Përfaqësueses së Kosovës dhe Planin Profesional të Punës së Drejtorit.

X. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 42

1. Komisioni i garave është autoriteti kompetent për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregullore.
2. Të gjithë anëtarët e FPPK-së, lojtarët dhe pjesëmarrësit e paraqitur për pjesëmarrje dhe të përfshirë në aktivitetet e Federatës, i nënshtrohen dispozitave të kësaj Rregulloreje.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Rregullorja për sistemin e garave e vitit 2019.

Neni 43

1. Bordi i FPPK-së mund ti propozojë Kuvendit të FPPK-së që disa gara të organizohen ndryshe nga ajo që është e paraparë me këtë Rregullore.

2. Kuvendi ka të drejtën të bëjë ndryshimin e sistemit të garave dhe i njëjti bëhet pjesë e kësaj Rregulloreje.

Neni 44
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i FPPK-së dhe e njëjta publikohet në faqen zyrtare të Federatës.

Kryetari:
Jeton Beqiri